



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1961/2 prot.,

Datë: 18.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Caushi M*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt “Rikostruksion rruge në Njësine Administrative Ishëm” me fond limit 16,665,708.19 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durres.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “*Caushi M*” SHPK me NIPT L884198010 dhe adresë Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-rë, zonat kadastrale 1090, nr. Pasurie, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durres  
Sheshi “Iliria”, Durrës

Në datën 17.07.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1961/2024 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4337 e operatorit ekonomik “*Caushi M*” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt ‘*Rikostruksion rruge ne Njesine Administrative Ishem*’ me fond limit: 16665708.0 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durres.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Caushi M” SHPK.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Caushi M” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1961/2024 prot., datë 17.07.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4337.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*- Për ofertuesin CAUSHI M me NIPT L884198010, me vlerë të ofertës 10'672'000 lekë, dhe oferte ekonomike të korrigjuar në vlerën 10'684'000 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nepermjet anetareve L. F dhe B. M, gjate shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik CAUSHI M: 1. Nuk përmbush pjesën e tretë të shtojcës 8, “Kriteret e perzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklarate mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, si dhe mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pasi ofertuesi deklaroi se drejtuesin teknik nuk e ka të angazhuar në kontrata të tjera. Nderkohe drejtuesi teknik është i angazhuar në kontratën publike me objekt “Rikualifikim hapsira publike në lagjen nr.13 dhe nr.6”, e cila është në proces zbatimi. Mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, KVO, nepermjet anetareve L. F dhe B. M, vendos që ofertuesi CAUSHI M të mos kualifikohet.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 18.07.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**